



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA KOMERCIALE

Numri i lëndës: 2020:053320

Datë: 09.05.2024

Numri i dokumentit: 05726659

KA.nr.402/22

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS, GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS, Dhomat e Shkallës së Parë, Departamenti për Çështje Administrative, gjyqtari Arben Toska, në konfliktin administrativ të paditësit "A.C." BI me NUI 810043000 dhe seli në rrugën Yll Morina nr. 17 në Gjakovë, kundër të paditurit Komuna e Gjakovës me seli në rrugën në Gjakovë, objekti i kontesti anulimi i aktit administrativ, pas seancës publike të shqyrtimit kryesor të datës 30.04.2024 në të cilën nuk morën pjesë palët e as përfaqësuesit e tyre, më 9 maj 2024 dha këtë:

A K T G J Y K I M

- I. Refuzohet në tërësi si e pabazuar kërkesëpadia e paditësit "A.C." BI me NUI 810043000, ndaj të paditurit Komuna e Gjakovës me seli në rrugën në Gjakovë me të cilën ka kërkuar anulimin e vendimit nr. 01/070/01-9159 të datës 14.04.2020, njoftimi i datës 03.03.2020, njoftimi i datës 01.04.2020 dhe njoftimi i datës 29.04.2020, të së paditurit.
- II. Secila palë i bartë shpenzimet e veta procedurale të shkaktuar në lidhje me këtë procedurë.

A R S Y E T I M

I. Padia, kërkesëpadia dhe pretendimet e palëve

1. Paditësi përmes padisë së datës 18.05.2020 e ka iniciuar konfliktin administrativ me kërkesë për anulimin e vendimit nr. 01/070/01-9159 të datës 14.04.2020, njoftimi i datës 03.03.2020, njoftimi i datës 01.04.2020 dhe njoftimi i datës 29.04.2020, të së paditurit të së paditurit Komuna e Gjakovës me seli në rrugën në Gjakovë.
2. Ai në padi ka pretenduar se, vendimi i kundërshtuar është në kundërshtim me nenin 85 dhe 86 të LPA-së, nenin 137 dhe 182 të LPK-së, meqenëse me atë nuk janë dhënë shpjegime të qarta se mbi çfarë baze është refuzuar ankesa e tij, nuk përmban arsye mbi faktet vendimtare, nuk janë vlerësuar provat shkresore të karakteri zyrtar, si dhe nuk është administruar si provë certifikata e pronësisë në lëndën 960-20 e datës 06.06.2020. Më

tutje ka pretenduar se i Padituri është pronar i vetëm një pjese të lokalit, ndërsa për pjesën tjetër të lokalit në mënyrë të kundërligjshme e ka shpallur njoftimin e për dhënien në shfrytëzim të pronës së paluajtshme. Në këtë drejtim ka argumentuar se i Padituri nuk ka qenë pronar i pjesës tjetër të lokalit, rrjedhimisht nuk ka pasur të drejtë që ta jap në shfrytëzim atë pjesë.

3. Përveç kësaj, ka sqaruar se lokalit e ka në posedim me mirëbesim që nga viti 1960, gjegjësisht paraardhësi i tij me pëlqimin e banorëve tjerë me mjete vetanake financiare ka investuar në ndërtimin e një hapësire tjetër në sipërfaqe prej 11.9m² mbrapa lokalit afarist, në të cilën e përdorë për ruajtjen e produkteve të mishit. Në seancën për shqyrtimin kryesor nuk mori pjesë fare, ndonëse ishte ftuar me rregull.
4. I padituri në përgjigje e tij në padi e ka kundërshtuar kërkesëpadinë e Paditësit dhe i ka kërkuar gjykatës që ta refuzoj atë si të pabazuar. Ai e ka sqaruar rrjedhën e procedurës administrative dhe i ka dërguar shkresat e lëndës administrative.

II. Provat e administruara dhe gjendja faktike e konstatuar

5. Me qëllim të konstatimit të plotë dhe të drejtë të gjendjes faktike, gjykata i aprovoi të gjitha propozimet e palëve për administrimin e prova, me përjashtim të këqyrjes në vend. Në këtë drejtim, në seancën për shqyrtimin kryesor u administruan provat si në vijim: njoftimi për lirim të pronës i lëshuar nga i Padituri për Paditësin më 29.04.2020; vendimi me nr.01/070/01-9159 i datës 14.04.2020 i të Paditurit; njoftimi publik për dhënien në shfrytëzim afatshkurtër të pronës së paluajtshme komunale- dyqanet me nr. të protokollit 01nr060101-7346 të datës 03.03.2020 lëshuar nga i Padituri; ankesa e Paditësit e protokolluar me nr.01-070/019153 me datën 07.04.2020; certifikata e njësisë kadastrale O-70705029-03307-0-34-2-3-0 e lëshuar nga Zyra Kadastrale në Gjakovë më 06.04.2020; certifikata e regjistrimit për paditësin e lëshuar nga ARBK e datës 11.03.2020, si dhe komplet shkresat e lëndës të procedurës administrative të cilat i padituri i ka dorëzuar në përgjigje në padi bazë nenit 37.2 lidhur me nenin 43.1 të LKA-së.
6. Këqyrjen në vend gjykata e refuzoi, pasi gjykata nuk e vlerësoi të nevojshme që për vërtetimin e ndonjë fakti, apo për sqarimin e ndonjë rrethane, duhet të bëhet vrojtimi i drejtpërdrejt nga gjykata e çështjes, sipas nenit 326 para. 1 të LPK-së.

7. Gjykata pas analizimit të provat të cekura më lartë në kuptim të nenit 8 të LPK-së dhe duke i zbatuar rregullat e të provuarit nga neni 322 i LPK-së lidhur me nenin 63 të LKA-së e konstatoi gjendjen faktike të përshkruar më poshtë.
8. Më 03.03.2020 i Padituri kishte shpallë njoftimin për dhënin në shfrytëzim afat shkurtë të pronës së paluajtshme komunale-dyqanet, mes të cilëve ishte edhe njësia kadastrale O-70705029-03307-0-34-2-3-0 (këtu e tutje Lokali).
9. Për Lokalin kishin paraqitur ofertë 7 subjekte, në mesin e tyre edhe Paditësi. Pas shqyrtimit të dokumentacionit relevant, i Padituri kishte vlerësuar se një subjekt tjetër i kishte plotësuar kushtet më së miri, rrjedhimisht më 01.04.2020 e kishte shpallë njoftimin për fituesin e kontratës lidhur me Lokalin. .
10. Më 07.04.2020 Paditësi kishte paraqitur ankesë kundër njoftimit për shpalljen e fituesit për Lokalin, ndërsa i Padituri e kishte refuzuar ankesën përmes vendimin e goditur nr. 01/070/01-9153 të datës 14.04.2020.
11. Më 29.04.2020 i Padituri kishte lëshuar një njoftim për Paditësin, me të cilin e kishte ftuar këtë të fundit që largohet nga Lokali deri më 05.05.2020, në të kundërtën ai do të marr masa ligjore.
12. Provat tjera të administruara, gjykata i gjeti edhe disa fakte tjera, siç është zhvillimi i procedurës kontestimore mes ndërgjyqësve, e cila kishte përfunduar me tërheqje të padisë nga këtu Paditësi, megjithatë ato nuk relevant për të vendosur ndryshe, prandaj gjykata vendosi të mos lëshohet në elaborimin e hollësishëm të tyre.

III. Vlerësimi meritor i rastit

13. Gjykata në rend të parë e shqyrtoi se a ka pasur kompetencë i Padituri për ta dhënë vendimin e goditur dhe gjeti se në bazë të nenit 15, 19 dhe 20 të Ligjit 06/L-092 për Dhënie në Shfrytëzim dhe Këmbimin e Pronës së Paluajtshme të Komunës ai ka pasur autorizim ligjor për fillimin dhe zhvillimin e procedurës konkretet administrative, si dhe për të vendosur për ankesën e Paditësit. Në këtë drejtim, gjykata vëren se nga Paditësi nuk ishte ndritur asnjë pretendim i kësaj natyre.
14. Përveç kësaj, gjykata vëren se i Padituri ka dhënë arsyetim të mjaftueshëm për të gjitha çështjet relevante të rastit, si dhe për të gjitha pretendimet e Paditësit, që i ka paraqitur në kundërshtimin e tij. Kështu, nga arsyetimi i aktit administrativ të goditur janë dhënë

arsye për çdo pretendim ankimor të Paditësit, duke elaboruar të gjeturat e të Paditurit, si organ kompetent për të vendosur lidhur me ankesën e Paditësit. Gjykata i vlerëson si pabazuara pretendimet e Paditësit lidhur me të metat e vendimit të goditur lidhur me arsyetimin. Në rend të parë, përmbajtja e arsyetimit rregullohet me nenin 48 të LPPA-së, e jo sipas dispozitave të LPA-së, siç u është referuar Paditësi, sepse LPPA e ka shfuqizuar LPA-në. Përveç kësaj, arsyetimi i vendimit të goditur i përmban të gjitha elementet obligative sipas nenit 48 të LPPA-së.

15. Gjykata gjithashtu konstaton se i Padituri e ka konstatuar në mënyrë të plotë dhe të drejtë gjendjen faktike, si dhe nga faktet e vërtetuara ka ardhur në përfundimin e drejtë të gjendjes faktike. Në këtë drejtim, gjykata e përkrah qëndrimin e të Paditurit si organ administrativ, se Paditësi në ankesën e tij nuk ka ofruar asnjë provë bindëse për t'i vërtetuar pretendimet tij. Në këtë drejtim gjykata e vlerëson si pabazuar pretendimin e Paditësit se i Padituri nuk është pronar i pjesë tjetër të lokalit, pasi në konfliktin administrativ gjykata nuk ka tagër të vlerësoj kontestet pronësore ose të ngjashme që kanë ndërgjyqësit. Ngjashëm edhe me pretendimet e Paditësit lidhur me investimet në krijimin e hapësirave të reja: në rend të parë Paditësi nuk ka paraqitur asnjë provë lidhur me këtë. Së dyti, saktësia eventuale e këtyre pretendimeve nuk lidhet fare me kushtet për paligjshmërinë e vendimit të goditur.
16. Për arsyet e cekura më lartë gjykata përfundimisht vlerëson se vendimi i goditur është nxjerrë duke i respektuar dispozitat e procedurës administrative, organi administrativ e ka konstatuar në mënyrë të plotë dhe të drejtë gjendjen faktike, i ka zbatuar drejtë dispozitat materiale administrative, si dhe i Padituri ka qenë organ kompetent për nxjerrjen e vendimit të tillë, rrjedhimisht nuk ka asnjë arsye ligjore që ai të anulohet, për pasoj e refuzoi si të pabazuar kërkesëpadinë e Paditësit.
17. Meqenëse i Padituri në përgjigjen në padi kishte kërkuar që t'i paguhen shpenzimet procedurale, atëherë lidhur me atë kërkesë gjykata vendosi në bazë të nenit 64 të LKA-së.
18. Prandaj, bazuar në nenet 13, par. 1, nën par. 1.12 lidhur me par. 5 të Ligjit nr. 08/L-015 për Gjykatën Komerciale dhe nenin 46 të Ligjit për Konfliktet Administrative, gjykata vendosi si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Gjykata Komeriale e Kosovës

Dhoma e Shkallës së Parë, Departamenti për Çështje Administrative

KA.nr.402/22

Gjyqtari

Arben Toska

UDHËZIMI PËR MJETIN E GODTIJES: Kundër këtij aktgjykimit mund të paraqitet ankesë brenda afatit prej pesëmbëdhjetë (15) ditëve nga dita e pranimit. Ankesa në formë të shkruar dhe në ekzemplarë të mjaftueshme për gjykatën dhe secilën palë tjetër dorëzohet në këtë gjykatë, ndërsa i drejtohet Dhomës së Shkallës së Dytë të Gjykatës Komeriale.